

ADINGMARKER - P

Lyerje e cilësisë së lartë për shënimin e nënshtresave të betonit dhe të asfaltit, e prodhuar në bazë të rrëshirave sintetike dhe tretësve

Fusha e aplikimit:

Adingmarker P është i dedikuar për shënimin e rrugëve dhe sinjalizimi rrugor dhe si mbrojtje dekorative përfundimtare e dyshemeve, mureve të sipërfaqet e suvatuara dhe të asfaltit. Përdoret në pozita të ekspozuara në ndikesa atmosferike, agresion kimik, si dhe në pozita të ngarkuara mekanike, siç janë punime të dyshemeve në depo, garazhe, objekte industriale, terrene sportive-rekreative, fasada përfundimtare dhe të sipërfaqet e suvatuara, xhepa muri të objekteve dhe ngjashëm. ADINGMARKER P aplikohet si pjesë e sistemit epoksid për përpunimin e shtigjeve për këmbësorë, në ura në kombinim me prajmer epoksid për nënshtresë të lagët ADINGPOKS 1PV.

Cilësi:

- lyerje një-komponentëshe;
- adezion i shkëlqyer për nënshtresën;
- e mbyll strukturën sipërfaqësore të nënshtresës;
- rezistencë në acide dhe baza të holluara, tretje të kripërave dhe vajrave minerale;
- rezistent në ndikesa atmosferike;
- rezistent ndaj ujit;
- rezistent në ndikesa atmosferike;
- rezistent në hollim;
- UV stabil;
- në dispozicion në më tepër ngjyra;
- aplikim i thjeshtë dhe i shpejtë;
- i lehtë për mirëmbajtje;

Karakteristika teknike:

Cilësi	Metodë	Vlerë e deklaruar
Dukje	-	Përzierje e ngjyrosur pastoze
Dendësia	EN ISO 2811-1	(1,7+1,75) g/cm ³
Viskozitet para hollimit	EN ISO 2431	Hapje d=6 mm t= 60s
Kohë e tharjes në prekje 20° C	EN ISO 9117	(10-15) min
Kohë e fortësimit në 20°C	EN ISO 9117	(20-25) min
Periudhë kohore Midis vënies së dy shtresave në 20° C	-	(120-180) min
Elasticitet i lyerjes	MKC.3.C2.240	Pa paraqitje të plasaritjeve dhe vendeve të qëruara
Indeks i hollimit	MKC.3.C2.240	TAM=180 mg
Rezistencë në rrëshqitje	EN 1436	57 SRT njësi
Rezistencë në akull dhe kripë	MKC.3.C2.240	Pa paraqitje të plasaritjeve dhe shkoqjes së nënshtresës
Ngjithshmëri e ngjyrës	MKC.H.C8.059	Shkallë i qërimin "0"
Rezistencë e ngjyrës në UV rrezatim:	-	Pa ndryshime

Metodologjia e realizimit:

Përgatitje e nënshtresës

Nënshtresa duhet të jetë e fortë, e thatë, e pastër, pa yndyra, pa pluhur, pa prani të kondenzateve dhe me lagështi maksimale 7%. Adingmarker është lyerje e hollë dhe për të fituar dukje e mirë përfundimtare dekorative, nevojitet që përpunimi përfundimtar të jetë me teksturë fine. Temperatura e nënshtresës, ajrit dhe e Adingmarker P i gatshëm për aplikim, duhet të jetë në kufijtë midis +5°C dhe +35°C, në lagështi relative të ajrit deri 65%. Nëse ky kufizim nuk respektohet, mund të ndodh paraqitja e kokrave të ajrit të lyerja e aplikuar.

Nënshtresë asfalti

Asfalti në të cilin vendoset lyerja duhet të jetë i shëndoshë, i thatë, i pastër dhe pa pluhur. Pastrimi nga pluhuri duhet të bëhet me ajër nën presion.

Nënshtresë e re betoni

Nënshtresa e betonit duhet të thatë e shëndoshë, e thatë, e pastër, pa yndyra dhe pa pluhur. Lëngu i çimentos, mbetjet nga suvaja, ngjyra dhe yndyra duhet të mënjanohet në mënyrë mekanike ose me përdorimin e mjeteve kimike. Më në fund nënshtresës duhet ti mënjanohet pluhuri me thithëse industriale.

Nënshtresë e vjetër betoni

Nënshtresë e pastër dhe e shëndoshë është parakushti kryesor për arritje të adezionit të shkëlqyer. Njëlloj edhe si te nënshtresë e re e betonit, mënjanimi i lëngut të betonit bëhet në mënyrë mekanike. Yndyrërat që kanë depërtuar në nënshtresën duhet të mënjanoher me detergjent ose me preparate speciale për atë dedikim. Nëse ekzistojnë dëmtime të nënshtresës, ato duhet të sanohen me materiale përkatëse për sanim.

Nënshtresë me lyerje ekzistuese

Adingmarker P mund të vendoset në nënshtresë me lyerje ekzistuese, vetëm nëse lyerja, që është përdorur paraprakisht është e fortë në mënyrë të mjaftueshme dhe stabile në tretës. Te këto nënshtresë, para vendosjes të lyerjes së re, patjetër duhet të kontrollohet ai adezion midis lyerjes ekzistuese dhe nënshtresës për të parë nëse këto shtresë mund të jenë nënshtresë për lyerjen e re. Nëse adezioni është i dobët, atëherë shtresat e vjetra duhet të mënjanoher në mënyrë mekanike. Nëse adezioni e shtresave ekzistuese është i mirë, rekomandojmë që sipërfaqet e tyre të përpunohet me zumpare, të mënjanoher pluhuri me procedurë të thatë, e mandej të bëhen fusha provuese, ku në sipërfaqe të caktuara do të vendoset shtresë e re e ngjyrës.

Vërejtje:

Lyerja ekzistuese në bazë uji edhe në rastin kur është e shëndoshë dhe me adezion të mirë për nënshtresën, patjetër duhet të mënjanoher tërësisht, para se të vendoset Adingmarker P.

Nënshtresë poroze

Në rastin kur nënshtresë është poroze, rekomandohet në sasinë për vendosje në shtresën e parë të Adingmarker P, të shtohet rreth 50% Dekosill. Kjo përzierje nuk duhet të hollon në mënyrë shtesë. Në këtë mënyrë mbyllet dhe përfordohet nënshtresë poroze, me çka do të zvogëlohet rreziku nga efekti i pa barazuar estetik.

Vendosje:

Vendosja e Adingmarker P bëhet me furçë, cilindër ose me makinë, me spërkatje me pompë pa ajër (airless), në 1 deri 3 shtresë, me trashësi të shtresës së thatë të një lyerje prej 150-200µ.

Për vendosje të shtresës së parë, materiali hollon me 3 – 5 % Rastvoruvaç P, pas së cilës masa përzihet me përzierje të ngadalshme deri në homogjenizimin e plotë. Gjatë hollimit të materialit, duhet të kihet kujdes që sasia që hollon ti përgjigjet sasisë së nevojshme për vendosje në një shtresë të sipërfaqes për përpunim.

Shtresë e dytë dhe e tretë vendoset me hollim deri 3 %. Distanca kohore e aplikimit midis shtresave, në temperaturë prej 20°C është 2 – 3 orë. Sipërfaqet e punuara duhet të mbrohen nga shkuja e fuqishme, shiu, akulli dhe pluhuri në periudhë prej 12 orë. Temperatura e nënshtresës gjatë aplikimit duhet të jetë më e lartë se 5° C.

Vërejtje:

Uji i cili përmban kripëra për shkrirje, mund të shkaktojë humbje të shkëlqimit dhe laramani të ngjyrës te sipërfaqet e trajtuara me Adingmarker P, por kjo nuk ndikon në karakteristikat mbrojtëse të lyerje.

Vendosje makinerike me pompë pa ajër

-presioni (150-200) bar

-diznë (pipëz spërkatëse) 6.35; 7.45: 8.45

-këndi i spërkatjes: në kënd të drejtë në raport me nënshtresën dhe distancë prej 20 – 40 cm.

Mirëmbajtje:

Jetëgjatësia e lyerjes varet nga mënyra e mirëmbajtja e mirë e saj. Dyshemeja e përpunuar me Adingmarker-P zakonisht mund të pastrohet edhe me makina me furça të buta rrotulluese, me detergjente të tretura në ujë.

Shpenzimi:

0,50±0,60 kg/m² (dy shtresë)

Pastrimi:

Veçat dhe pajisja pastrohen me Rastvoruvaç-P, menjëherë pas përdorimit.

Paketimi:

Govata teneqeje prej 4 dhe 20 kg.

Vendosja në depo:

Në ambalazh origjinal, të mbyllur, në hapësira të thata, në temperaturë prej 5°C deri 30°C, i mbrojtur nga ekspozimi i drejtpërdrejtë në rrezet e diellit, më larg nga burimi i nxehtësisë.

Afati i përdorimit: 9 muaj.

Ngjyra standarde:

RAL1003; RAL1018; RAL1023; RAL3001; RAL3016; RAL3020; RAL5005; RAL5012; RAL5017; RAL6010; RAL7015; RAL7046; RAL9003, RAL9004.

Rrezik për jetën: Nevojitet të shmanget kontakti i prodhimit me lëkurën ose sytë, si dhe thithje e drejtpërdrejtë. Në rast të kontaktit të befasishtëm të prodhimit me lëkurën, ai duhet të mënjanoher menjëherë me ujë dhe sapun. Nëse materiali spërkat në sy, nevojitet që ato menjëherë të shpëlahen me shumë ujë dhe të kërkohet ndihmë mjekësore. Nëse gëlltitet, nevojitet të kërkohet ndihmë mjekësore.

Zjarr: Adingmarker – P është i ndezshëm.

Pastrimi dhe vendosja në depo: Mbetjet e pa lidhura të Adingmarker-P pastrohen me Rastvoruvaç-P. Ambalazhi i vjetër i përdorur duhet të deponohet sipas dispozitave dhe rregullatave lokale për atë lloj të mbetjeve.

Rekomandojmë që mënyra e vendosjes dhe sasia e nevojshme të përshtatet në kushtet e objektit, si dhe me përdorim të domosdoshëm të pajisjes përkatëse.